



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:137141
Datë: 24.01.2025
Numri i dokumentit: 06776772

P.nr.2759/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja e vetme gjykuese Edita Çanta, me Bashkëpunëtorin Profesional Lavdim Mehmeti, në çështjen penale ndaj të pandehurit G.T. për shkak të veprës penale *Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370, par.8 lidhur me par.6 dhe 1* të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me shenjën PP.II.nr.4002/23, të datës 25.07.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, i hapur për publikun, me datë 24.12.2024, në të cilin shqyrtim ishin të pranishëm Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, i pandehuri G.T. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av.Berat Tmava dhe i dëmtuari G.S., e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, me dt.26.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 24.01.2025, e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri G.T., i biri i R. dhe H., e gjinise M., i lindur më //, në H., P., banon në rr. "A.A.", Prishtinë, me numër personal //, i martuar, baba i dy femijeve, i papunë, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 03.05.2023, rreth orës 18:00, në rrugën Prishtinë-Keqekoll, saktësisht në fshatin Stallovë, i pandehuri G.T., vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 53, par.1 të Ligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, dhe me këtë nga pakujdesia shkakton aksident trafiku, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që në ditën kritike i pandehuri gjersa ishte duke drejtuar automjetin e tipit "VW transporte", me targa të regjistrimit 01-//, nuk ia ka përshtatur mënyrën e levizjes kushteve dhe rrethanave të krijuara në rrugë, nuk përkushtohet sa duhet gjatë ngasjes së automjetit, gjegjësisht si pasojë e pakujdesisë, repsektivisht mungesa e koncentrimit në drejtimin e automjetit, njëherit edhe përkundër që ka qenë duke levizur në rrugën Prishtinë-Keqekollë, në fshatin Stallovë në Prishtinë, nga drejtimi Kaqekoll për në drejtim të Prishtinës nga pakujdesia dhe vëmendja jo e duhur gjatë ngasjes së automjetit duke mos ju përshtatur kushteve atmosferike (kushtet sipërfaqësore të rrugës së lagur, kushtet klimatike me shi), hyn në rrugë kthesë e thellë, dhe kalon në shiritin e kahjes së kundërt dhe me pjesën e përparme të anës së majtë e godet kamionin/mjet transportues Volo FH1242T, ngjyrë e kuqe, me targa 01-//, në anën e majtë duke i shkaktuar dëme materiale në kamion dhe rimorkio, i cili ishte duke lëvizur në shiritin e tij qarkullues dhe atë nga drejtimi i Prishtinës për në drejtim të Kaqekollës, të cilën e drejtonte i dëmtuari Kastriot Bajrami, ku si pasojë e këtij aksidenti dëme materiale pësuan dy automjetet ndërsa pasagjeri-i dëmtuari G. S., që ishte në veturën e të

pandehurit, pëson thyerje në forme spiraleje shumëcopëshe të trupit, të kockës së krahut të dorës së majtë, dëmtim i nervit radial, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mbrehtë, i topitur), dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, lëndime këto të përshkruara më hollësisht në Akt-ekspertimin mjeko-ligjor të dr. Valon Hyseni, të datës 23.06.2023,

Me këtë ka kryer veprën penale **Rrezikim i trafikut publik**, nga neni 370, par.8 lidhur me par.6 dhe lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtarja e vetme, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 38, 43, 44, 73, 74 të KPRK-së, si dhe neni 365 të KPPK-së, të njëjtin:

E GJYKON

I.Ashtu që të pandehurit **G.T.** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2000) euro, të cilin dënim duhet ta paguajë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.I pandehuri dënimin me gjobë mund ta paguaj në dy këste më së largu deri me datën 05 të muajit vijues.

II.Në rast se dështon ta paguajë gjobën atëherë konform neni 43 par.3 të KPRK-së, gjykata do të zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, si në pikën I të këtij dispozitivi.

III.Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumë aq sa do të bëhet sipas llogaritjes përfundimtare nga arka e gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) euro, në emër të kompensimit të viktimave shumë prej njëzet (20) euro, për ekspertizë të komunikacionit shumë prej dyzet euro e tetëdhjetë e tetë cent (40.88) euro, dhe për ekspertizë mjeko-ligjore shumë prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

IV.Të dëmtuarit Kastriot Bajrami dhe Gan Sopjani për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 4002/23, të datës 25.07.2023 ndaj të pandehurit G.T. për shkak të veprës penale *Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370, par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së*

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 24.12.2024, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri G. T., është deklaruar fajtor për veprën penale që akuzohet duke shtuar se *“ka qenë e paqëllimshme, kushtet atmosferike kanë qenë të këqija, më vjen keq për atë cka ka ndodhë, kanë qenë rrugët e këqija, i kërkoj falje të dëmtuarve dhe gjykatës, premtoj që nuk do të përsëris veprën penale është hera e parë që jam në gjykatë, nuk kam kryer asnjëherë vepër penale.”*

Mbrojtësi i të pandehurit, av.Berat Tmava, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, ka deklaruar: *“I mbrojturi im , pas konsultimit me mua në cilësinë e avokait e pranon*

fajësinë ashtu sic e ngarkon aktaluzia duke pasur parasysh pasojat dhe benefitet lidhur me këtë veprim procedural. Shpreh keqardhje për këtë cka i ka ndodhur, por duke pasur parasysh edhe kushtet atmosferike në atë kohë, një pjesë të kontributit e ka dhënë edhe mosmirëmbajtja e asaj pjese të rrugës nga kompanitë përgjegjëse e që fatkeqësisht ka ndodhur aksidenti, ku si pasojë është lënduar si vozitësi tani i pandehuri G.T. e poashtu edhe këtu i dëmtuari, njëkohësisht shoku i tij Gani Sopjani. Dua të potencoj se, sa i përket të mbrojtur tim është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, poashtu ka ndjerë dhimbje dhe keqardhje shumë të madhe për shkak që i është lënduar shoku dhe konsideroj se në raport me të mbrojtur tim janë plotësuar kushtet nga neni 71, par.1, nënpar. 1.3 të KPRK-së, që pranimin e fajësisë gjykata ta trajtoj si rrethanë posacërsisht lehtësuese, pasi i mbrojturi im është edhe kryefamiljar, dhe fatkeqësisht kjo vepër i ka ndodhur nga sic thamë më lartë duke kontribuar edhe gjendja errugës në atë pjesë dhe e lusim gjykatën që të mbrojturit tim t'i shqiptoj një dënim sa më të butë, apo në rastin më të pavolitshëm t'i shqiptoj një dënim me burgim nën minimumin e paraprë me ligj sic ja mundësojnë dispozitat ligjore, dhe konform nenit 4 me pëlqimin e palës-të pandehurit t'ia zëvendësoj me dënim me gjobë, konsiderojmë se me këtë cka u propozua arrihet qëllimi i dënimit sic parashihet me nenin 38 të KPRK-së”.

Prokurori i shtetit ka deklaruar: *‘Nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse i njejti pranim gjen mbështetje në provat që gjenden në aktakuzë, andaj i propozojmë gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit, ku lidhur me llojin e caktimit të dënimit dhe lartësisë së tij gjykatës i propozojmë që si rrethanë rënduese të merr parasysh nenin 70 par. 2, pika 1.2 që është shkalla e lartë e pjesëmarrjes në vepër penale pasi që në bazë të ekspertizës i pandehuri është shkaktar kryesor i veprës penale, ndërsa sirrethanë lehtësuese të marr pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit gjtë gjithë procedurës penale, keqardhja e shfaqur nga i pandehuri për rastin e ndodhur dhe sjellja e tij pas këtij rasti”.*

I dëmtuari G. S. ka deklaruar: *“Nuk dua që G. T. të dënohet, pasi që e kam shok, ndërsa për kërkesën pasurorore juridike do ta realizoj në kompaninë e sigurimeve, po ashtu është kujdesur për mua prej momentit të aksidentit”.*

Gjykata pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPRK-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 1, dhe 2 të KPRK-së, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas pranimin të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes se kushteve në referim të nenit 242 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPRK-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtarja ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase në veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se i njëjti është penalisht përgjegjëse.

Duke u bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e

dënimit. Si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata e ka marrë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit; se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, i premtos gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla e as të tjera penale. Ndërsa gjyqtarja e çështjes rrethanë rënduese nuk ka gjetur.

Sipas bindjes së gjyqtarës, dënimi me gjobë ndaj të pandehurit, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtarja e çështjes, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë Ligjit nr.05/L-036.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.2759/23, të datës 24.01.2025

Bashkëpunëtori Profesional,
Lavdim Mehmeti

Gjyqtarja,
Edita Çanta

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditëve, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.